

Бр./Nr. 04-1084/1



25.07.2022 год./viti
КОПЈЕ - ШКУР

Republic of
NORTH MACEDONIA

DTIDZ FREE ZONES

Në bazë të nenit 4 nga Ligji për praktikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19 dhe 103/21), Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale paraqet :

**SHPLLJE PUBLIKE PËR PRAKTIKANT NË DREJTORINË E ZONAVE ZHVILLIMORE
TEKNOLOGJIKE INDUSTRIALE**

NUMËR 01/2022

Në bazë të nenit 4 nga Ligji për praktikë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/2019 dhe 103/21), Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale paraqet SHPLLJE PUBLIKE për angazhim të 4 (katër) praktikantëve për njësitë organizative me sa vijon :

- Një praktikant në Sektorin për kujdesje të shfrytëzuesve dhe komunikim me shfrytëzues potencial në ZZHIT, student në nivelin e parë ose të dytë të studimeve në lëmin e shkecave ekonomike;
- Një praktikant në Sektorin për ndihmë shtetërore dhe kontrollim i kontratave në zhvillim, student në nivelin e parë apo të dytë të studimeve në lëmin e shkencave ekonomike ose shkencave juridike;
- Një praktikant në Sektorin e marketingut dhe komunikimit, student në nivelin e parë apo të dytë të studimeve në lëmin e marketingut ose marrëdhënieve me publikun;
- Një praktikant në Sektorin e planifikimit, themelimit, ndërtimit dhe zhvillimit të ZZHTI, student në nivelin e parë apo të dytë të studimeve në lëmin e ndërtimtarisë ose arkitekturës;

Kohëzgjatja e punës praktike është 3 (tre) muaj. Orari i punës së praktikantit është 40 orë në javë (orar i plot pune). Praktikanti ka të drejtë konpenzim për punën praktike, e vërtetuar në pajtim me Ligjin për punë praktike.

Kushtet që duhet të plotëson praktikanti:

- Të mos jetë në marrëdhënie pune;
- Të mos jetë më i moshuar se 34 vjeç;
- Të jetë i diplomuar apo student i vitit të fundit studimor të nivelit të parë apo të dytë;
- Të ketë shkathtësi të mira komunikative;
- Të posedon vetiniciativë, vendosmëri dhe dëshirë për mësim;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze;

- Të ketë njohuri në Microsoft Office

Dokumentacioni për aplikim:

- Biografi (SV) nga aplikuesi;
- Dëshmi për llojin e studimeve që është duke vijuar (kopje nga indeksi);
- Dokument nga institucioni arsimor se udhëzohet në punë praktike, të shtypur në memorandumin oficial me vulë dhe firmë nga institucioni arsimor.

Cka presim nga praktikantët tanë?

- Qasje të përgjithshme ndaj detyrave dhe pjesëmarrje aktive në procesin e punës praktike,
- Duke marrë iniciativë dhe kreativitet,
- Dëshira për përfitim të shkathtësive të punës praktike.

Nëse jeni afër fillimit të një kariere të re në një atmosferë pozitive dhe dinamike me mundësi të ngritjes së njohurive si dhe shkathtësive tuaja, nëse keni interes që të përfitoni njohuri nga fusha e punës së Drejtorisë për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale, Ju ftojme të konkuroni në shpalljen publike dhe të dërgoni Biografi (SV) e cila së bashku me dokumentacionin e cekur ta parashtroni në email adresën : hr@fez.gov.mk.

Kandidatët e paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet do të thirren në intervistë, pas së cilës bëhet zgjedhja finale dhe do të firmoset Kontratë për praktikë.

Afati zgjat 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes.

Drejtore

Jovan Despotovski

